

Nr. 369
18.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 168/1 prot.

Gjirokastrë, më 12.2.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 3, datë 29.1.2026, “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor”, konfirmohet.
2. Vendimi nr. 4, datë 29.1.2026, “Për miratimin e planit operacional për vitin 2026 në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Tepelenë”, konfirmohet.
3. Vendimi nr. 5, datë 29.1.2026, “Për zhvillimin e pronës në fshatrat Salari, me numër pasurie 1094/4, 1094/5, zona kadastrale nr. 3252, Gusmar, me numër pasurie 764, 134, 131, 182, 132, zona kadastrale nr. 1913, Progonat, me numër pasurie 735, 752, 717, 721, 722, 729, 728, 702, 700, 625, 630, 636, 399, 649, 659, 682, 686, zona kadastrale nr. 3057, me zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit, si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse në portalin E-Albania”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
4. Vendimi nr. 6, datë 29.1.2026, “Për zhvillimin e pronës në fshatin Dragot, me numër pasurie 392, zona kadastrale nr. 1529, me përfitues Bashkinë Tepelenë dhe zhvillues CESVI Albania (OJF), si dhe autorizimin e zhvilluesit apo përfaqësuesit të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit me lejet përkatëse në portalin E-Albania”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

5. Vendimi nr. 7, datë 29.1.2026, “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”, konfirmohet.
6. Vendimi nr. 9, datë 29.1.2026, “Për miratimin e dhënies ndihmë financiare për dëmin e shkaktuar nga zjarri në banesën e z. Hasan Hoxha”, konfirmohet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

